

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **(UNIVERSITETI I PRISHTINËS)**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **(242-19-6956-1-1-1)**

Sa i përket tenderit për **(Furnizim me paisje te nderyshme)**

**ANKESË**

**1. Identifikimi i ankuesit\***

**ARITECH SHPK**

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

**Kilometri i 10 Prishtinë-Lipjan, përball QMI**

*(Adresa)*

**Graçanicë**

**10500**

*(Vendi)(Kodi postar)*

**+383 38 600 500**

*(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)*

**Fahri Avdiu**

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

**fahri@aritech-ks.com**

*(Adresa elektronike)*

**20.03.2020**

*(Data e parashtrimt të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)*



## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtoj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

\_\_\_\_\_  
(Emri i avokatit)

\_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

*Njoftimi për kontratë është publikuar në e-prokurim me dt. 16.09.2019, afati i fundit për dorëzim të ofertës është me datë 29.11.2019 h 14:00.*

*Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marr pjesë dy ofertues.*

*Aritech shpk ka ofruar çmimin më të lirë në këtë projekt tenderues.*

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po

☐

Jo

☒

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit?*



Po



Jo



#### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po



Jo



Ne pas njoftimit mbi vendimin e AK-se si dhe letres standarde per tenderuesin e eliminuar perkatesisht te Aritech shpk në afat të rregullt kohorë kemi paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim prane AK-së.

Nga AK fillimisht me date 07.02.2020 kemi pranuar leter standarde per tenderuesin e eliminuar.

Ne baze te saj kemi dorezuar kerkesen tone per Rishqyrtim prane AK-se me date 12.02.2020,

AK me date 14.02.2020 ka marr vendim qe te kthej lenden ne Rivleresim.

Pas Rivleresimit te lendes AK me date 02.03.2020 dergon njoftimin mbi vendimin e AK-se si dhe letren standarde per tenderuesin e eliminuar- Aritech shpk.

Kompania jone paraqet perseri Kërkesën për Rishqyrtim me datë 06.03.2020

AK pasi ka shqyrtuar kërkesën tonë me datë 11.03.2020 ka derguar pergjigje mbi vendimin lidhur me shqyrtimin e kërkesës ku edhe kishte vleresuar kerkesen tone si te pabazuar . Ne nuk kemi qene te kenaqur me vleresimin e tille prandaj duke u bazuar ne LPP-së paraqesim ankesë në OSHP kundër vendimit të AK-së.

#### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

AK ka shkelur gjatë realizimit të kësaj procedure ka shkelur dispozitat e LPP-së si më poshtë:

##### **Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.



**Neni 7**  
**Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

**Neni 59**  
**Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve**

1. Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacionin dytësor lidhur me këtë çështje.
2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohej ose pranohet nga autoriteti kontraktues ose të ofrohet nga një tenderues.
4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

**Neni 72**  
**Dokumentacioni dhe informacioni shtesë**

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

**Neni 108/A**  
**Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

9. Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohet me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim.

**Neni 109**  
**Afatet për Dorëzimin e Ankesës**

2. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.



## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

AK ka shkelur nenin 6 dhe 7 të LPP-së pasi që edhe pas kërkeses sone për Rishqyrtim nuk merr parasysh argumentet të cilat kanë të bëjnë me parimin trajtimit të barabartë për të dy operatorët ekonomik në këtë rast duke detektuar vetëm kompaninë Aritech shpk në lidhje me specifikimin teknik si dhe duke anashkaluar OE Botek shpk në lidhje me specifikimin teknik.

Shperblimi i OE Botek shpk ndikon drejtpërdrejt në shkelje të Nenit 6 përkatësisht në mosshfrytëzim të burimeve ekonomike në mënyrën me ekonomike.

Ky veprim mendojmë se duhet të sanksionohet pasi që e shkelë edhe parimin bazë të prokurimit publik- trajtimin e barabartë të ofertuesve.

Ne vijim do të paraqesim fillimisht arsyet e letres standarde për tenderuesin e eleminuar të datës 07.02.2020:

### Citojme:

*Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :*

1. Nuk keni sjellur Autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar.
2. CV-ja, e menaxherit nuk është e nënshkruar nga menaxheri ashtu si është kërkuar në dosjen e tenderit.
3. Nuk keni sjellur kopjet e pasqyrave financiare të Audituarra për 3(tri) vitet e fundit (Prej publikimit të njoftimit) ose raporti i auditorit për pasqyrat përkatëse (Auditori i Licencuar ose ndonjë Kompani e Auditimit-duhet të bashkëngjitet edhe kopja e licencës së Auditorit e noterizuar në origjinal për secilin vit). 400,000.00 €

### Perfundim Citati

Ne kemi ofruar deshmi dhe argumente AK-se për të tri arsyetimet si ne vijim:

AK me datë 22.11.2019 ka ngarkuar në sistem të e-prokurimit **B54 - Formularin për korigjimin e gabimeve** në lidhje me kriterin apo kërkesën për Autorizim nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i Autorizuar si ne vijim:





400,000.00 LLOT 1, Kopja e pasqyrave financiare të Audituara për 3(tri) vitet e fundit (ose raporti i auditorit për pasqyrat përkatëse (Auditori i Licencuar ose ndonjë Kompani e Auditimit- duhet ti bashkëngjitet edhe kopja e licencës së Auditorit e noterizuar në original për secilin vit).

se 400,000.00 LLOT 1, Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur; ose e. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.

Autoriteti kontraktues pas kërkeses për Rishqyrtim të datës 12.02.2020 të Aritech shpk ka vendosur që të kthejë lenden në Rivleresim.

Pas Rivleresimit të lendes nga ana e AK-se në kemi pranuar perseri me datë 02.03.2020 letren Standarde për tenderuesin e eliminuar.

Në letren standarde mbi arsyet e eliminimit të Aritech shpk qendron si në vijim:

Ju jeni eliminuar për arsye se :

Ju keni dorëzuar vendimin për menaxher të kontratës , mirpo CV e menaxherit nuk është e nënshkruar nga vet menaxheri.

Kërkesa nga AK në FDT: Autorizimi nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi.

Vlerësimi: Autorizimi nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi, është larguar gjatë procedurave të sqarimeve shtesë mirëpo, në dosjen e tenderit në fund të specifikimeve teknike për pozicionin 7. 8. është kërkuar që OE të ofrojnë ; "Garancioni: 2 vite nga prodhuesi (vërtetuar me deklaratën e prodhuesit)", por në dosjen e ofertuar nga ju pra - mungon deklaratata nga prodhuesi. Në tenderin e juaj keni dërguar një dok. "Terms of Condition" nga prodhuesi Lenovo, por që ky dokument nuk përmbushë kërkesën sipas dosjes së tenderit - për "Deklaratë mbi gradacionin nga Prodhuesi".

**Specifikimi teknik, Pozicioni 3.** Produkti i ofertuar nga ana juaj për këtë pozicion - kompjuteri HP 290G2, duke u bazuar në broshurën që ju keni dorëzuar nuk e përmbush kapacitetin për SSD 1TB ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit. Pra, nga Broshura e këtij produkti shihet qartë se ky model nga vet prodhuesi Lenovo nuk ofrohet / përkrah SSD me kapacitet 1TB.

**Specifikimi teknik, Pozicioni 4.** Produkti i ofertuar për këtë pozicion - Projektor Acer p1150, p1250, duke u bazuar në broshurën e dërguar nga ju, nuk e përmbush specifikat e kërkuara për "Image size "762 – 8890 or better", ose ne inch 30in-350in)" pasi që modeli i ofertuar nga ju i prodhuesit ACER përkrah maksimalisht image size;300inch gjejësisht

7620mm).

**Specifikimi teknik, Pozicioni 8.** Në specifikat teknike tek ky pozicion është kërkuar që pajisje të ketë *Thunderbolt*, mirëpo duke u bazuar në broshurën e këtij produkti ThinkPad L590, ky produkt nuk posedon *Thunderbolt*.

**Specifikimi teknik, Pozicioni 11.** Produkti i ofertuar për këtë pozicion - **ThinkCentre M920**, duke u bazuar në broshurën e dërguar nga ju, shihet se ky model i prodhuesit Lenovo nuk e ofron / përkrahë kartelën grafike **8GB** siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

#### Pika 1

Ne lidhje me CV-ne në vijim mund të shihni dy raste në udhezuesin operativ për prokurim publik sesi duhet të veprohet:

CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar	Mund të kërkohej informata sqaruese	69
CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, AK nuk mund të vendos	Mund të kërkohej informata sqaruese	69

Ne rregulloren apo udhezuesin operativ për prokurim publik siç mund të shihet në të dy rastet me lart fare nuk konsiderohet eliminimi i OE nëse eventualisht edhe mungon komplet CV-ja.

Ne kemi dorëzuar CV-ne për menaxher të projektit në fjalë e cila është valide, për më tepër konfirmojmë që personi i cili është caktuar menaxher nga kompania jone për këtë projekt është punëtor i rregullt në kompaninë tonë.

Ne kemi paraqitur gatishmerinë tonë që të vertetojmë në lidhje me menaxherin e angazhuar dhe CV-se se dorëzuar.

AK ka mundur të kërkojë sqarime duke u bazuar në Nenin 72 të LPP-se.

#### Pika 2

Ndërsa në lidhje me arsyetimin për Garancion nga prodhuesi për pozicionin 7 dhe 8.

Autoriteti kontraktues ashtu siç ka potencuar ka larguar kriterin për Autorizim nga prodhuesi (për të cilin edhe jemi eliminuar herën e parë)

Largimi i kriterit të tillë dhe eliminimi jone në lidhje me kërkesën në fjalë përderisja OE Botek shpk nuk ka dorëzuar garancionin nga prodhuesi nënkupton që kemi të bëjmë me trajtim jo të barabartë të operatoreve ekonomik.

Botek shpk ka dorëzuar një dokument për të cilin nuk është kërkuar nga Autoriteti juaj.

Megjithatë Autoriteti juaj nuk e klasifikon si dokument të mos dorëzuar Garancionin nga prodhuesi edhe nga OE i cili mendohet të shpërblehet me kontratë.



Dokumenti MANUFACTURER AUTHORIZATION FORM ( dokument i cili nuk eshte kerkuar), nuk mund te cilesohet deklarate per garancion nga prodhuesi.

**Pika 3 specifikim teknik pozicioni 3**

Ndersa ne lidhje me modelin e ofertuar te PC-se HP 290 G2 ne ju konfirmojme qe produkti ne fjale perkrah kapacitetin 1 TB SSD per te cilen ne do te mund te ju deshmonim fizikisht., duke ju sjellur nje moster fizike te njejt (HP 290 G2) ku mund te vertetohet qe modeli ne fjale posedon dhe suporton 1TB SSD.

**Pika 4 specifikim teknik pozicioni 4**

Kerkesa ne specifikim teknik per pozicionin 4 perkatesisht per Projektor ka qene:

Image size: 762 – 8890 or better.

Pershkrimi ka qene si me larte pa shtesen tuaj ashtu siç keni potencuar **ose ne inch 30in-350in.**

Sidoqofte ne konfirmojme qe produkti jone i ofertuar per projektorin ne fjale perkrah kerkesen tuaj per te cilen ne do te mund te deshmonim poashtu.

**Pika 4 specifikim teknik pozicioni 8**

Produktin te cilin ne kemi ofertuar posedon 2 \* usb type C qe eshte ekuivalent i kerkeses per Thunderbolt.

**Pika 5 specifikim teknik pozicioni 11**

Produkti i ofertuar nga ana jone Thinkcentre M920 e perkrah kapacitetin e karteles grafike 8 GB per te cilen do te mund te deshmonim per Autoritetin tuaj.

Edhe tek ky pozicion mund tju sjellim nje moster fizike ku mund te shihet qe suporton dhe funksionon me kartel grafike 8GB , konform kerkesave tuaja.

Ne vazhdim ne do te paraqesim disa pozicione te cilat deshmojne ne menyre te qarte mosplotesim te kerkesave nga ana e OE Botek shpk:

**Specifikimi teknik pozicioni 2**

Kerkesa ne specifikim teknik per monitor per pozicionin 2 ka qene:

Response time: **4ms**

Produkti i ofertuar nga OE Botek shpk nuk e perkrah kete kerkesa.

OE Botek Shpk ka ofertuar monitor Dell E2318H i cili response time e ka **5ms.**

Ne vijim mund te gjeni print screen nga broshura e dorezuar nga OE ne fjale perkatesisht per Dell E2318H:

Response time (typical)

5 ms (gray to gray - fast mode)

8 ms (gray to gray - normal mode)

Panel technology

In-plane switching, antiglare with 3H hardness

Ne oferte teknike Botek Shpk ka ndryshuar specifikimin teknik ne shperputhje me broshuren e dorezuar per pozicionin nr.2 apo per monitor siç mund te shihni me poshte:



## Dell 23 Monitor - E2318H - 58.4cm(23") Black

Specifikat e monitorit:

Panel: IPS, Backlight WLED, TFT-LCD

Resolution: Full HD (1920 x 1080)

Aspect Ratio: 16:9

Tilt Stand (back/forward 22°/-5°)

Contrast Ratio: 1000: 1 (Typical) or better

Response time: 4 ms

Connectivity: VGA, DP (HDCP Support), (least DP, VGA Cable included)

Garancioni: 2 vite

Broshuren origjinal nga prodhuesi mund ta gjeni ne :

[https://i.dell.com/sites/csdocuments/Product\\_Docs/en/dell\\_23\\_monitor\\_e2318h\\_product\\_spec\\_sheet.pdf](https://i.dell.com/sites/csdocuments/Product_Docs/en/dell_23_monitor_e2318h_product_spec_sheet.pdf)

Lehtesisht mund te verifikoni argumentin nga ana jone.

### Specifikimi teknik pozicioni 7 dhe 8

Kerkesa per pozicionin 7 dhe 8 ka qene qe bateria e laptopit te kete 6 cell.

Produkti i ofertuar nga OE eshte Dell Latitude 5500 i cili nuk e permbush kerkesen sipas specifikimit teknik te kerkuar.

Produkti i ofertuar per te dy pozicionet posedon **Bateri 4 cell** ashtu siq e kane potencuar ne specifikim teknik dhe ne broshuren e dorezuar.

Poashtu produkti me nr. Rendor 8 nuk ka thunderbolt sepse ne broshure potencohet qe eshte optional dhe gjithmone apo ne shumicen e rasteve dorezohen pa thunderbolt, pasi qe upgrade i cili eshte opsional hyn ne prodhim vetem per sasi te medha dhe te porositura paraprakisht , sasia prej 6 copeve nuk merret ne konsiderat nga asnje prodhues. Siq shihet me poshte ky model nuk mund ti kete ne te njejten kohe edhe USB TYPE C edhe THUNDERBOLT 3 , mirepo ose njerin ose tjetren e qe rrjedhimisht i mungon njera porte dhe nuk eshte ne perputhje me kerkesen ne specifikim teknik.


Mund te shihni me poshte deshmine per bateri/Cell dhe per thunderbolt e cila gjendet ne broshure.

## Battery

Table 21. Battery

Feature	Specifications		
Type	3-cell Lithium-Ion (42 WHr) ExpressCharge	3-cell Lithium-Ion (51 WHr) ExpressCharge	4-cell Lithium-Ion (68 WHr) ExpressCharge





1. Power connector port
2. USB 3.1 Gen 2 (USB Type-C) port with DisplayPort/Thunderbolt (optional)
3. USB 3.1 Gen 1
4. Smart card reader (optional)

Ne oferte teknike te dorezuar nga ana e OE Botek shpk eshte potencuar si ne vijim per baterine e cila perfshihet per pozicionin 7 dhe 8.  
Mund te shihni print screen nga oferta teknike:

**Bateri: 68Whr, me teknologji të avancuar me mbushje të shpejtë**


Bateria e ofertuar me larte siç eshte pershkruar 68Whr i ka 4 cell e jo 6 cell ashtu siç eshte kerkuar ne specifikim teknik apo te formulari standard i korigjimit te gabimeve perkatesisht Formulari B54.

#### **Specifikimi teknik poziconi 12**

Ne kerkese apo specifikim teknik eshte kerkuar qe monitor te kete **madhesine 32"**  
Produkti i ofertuar nga OE Botek shpk ka ofruar Monitor me pershkrim SAMSUNG modeli - U32J590UQU.  
Produkti ne fjale nuk e permbush kerkesen e Autoritetit tuaj sepse monitori i ofertuar e ka madhesine 31.5".

Deshmi :





Ndersa ju keni dorëzuar CV-ja , e menaxherit të pa nënshkruar.

Sa i përket pretendimit ankimor se nuk është përdorur neni 72 citojme RRUOP si me poshtë :

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm 69.

Përfundim citati

Fillimisht AK ka ngarkuar ne sistem Njoftimin per dhenie te kontrates duke shkelur Nenin 108/A pika 9 si dhe Nenin 109 pika 2 duke mos pritur afatet ligjore perkatese.

Veprimi i tille eshte ne kundërshtim me Nenet me lart sepse ngarkohet para afatit 10 ditor brenda te te cilit ankuesi ka te drejt te paraqes ankese ne OSHP.

AK ne pergjigje te saj ne lidhje me kerkesen per Rishqyrtim nuk eshte pergjigjur ne lidhje me pretendimet tona rreth mos trajtimit te barabarte te operatoreve ekonomik.

AK nuk eshte pergjigjur fare rreth pretendimeve apo argumenteve tona rreth mosplotesimit te kerkesave apo specifikimeve teknike te produkteve te ofertuara nga ana e OE Botek shpk.

Ndersa ne lidhje me pretendimin me lart rreth CV-se ne besojme qe tenderi refuzohet vetem ne rastet kur nuk plotesohen kerkesat.

Kerkesat apo mos plotesimi i kerkesave ne kete rast besojme qe nenkupton ne rastet kur kerkohet p.sh Inxhinier i caktuar ndersa menaxheri ne fjale eshte ekonomist.

Ne me lart kemi cekur edhe dy raste te tjera sipas udhezuesit operativ per prokurim publik per te cilat mund te kerkohen informata sqaruese.

Kerkojme nga Organi shqyrtues i prokurimit qe te merr vendim si ne vijim:

## V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE "ARITECH SHPK" lidhur me tenderin "Furnizim me paisje te nderyshme"

ANULOHET Njoftimi mbi vendimin e AK-se "UNIVERSITETI I PRISHTINËS" dhe tenderi të Rikthethet ne Rivleresim.

AK-së, të i kërkohej që t'i trajtoje te gjithë OE-te ne menyre te barabarte gjate Rivleresimit duke u bazuar ne kriteret e percaktuara sipas dosjes se tenderit si dhe LPP-se.



## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Dëme materiale direkt është mohimi i fitimit të caktuar, shpenzimet e përgatitjes së ankesës etj.**

## 9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim i dates 07.02.2020
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.
- e) Dëshmi nga E-prokurimi rreth kërkesës për Rishqyrtim
- f) Pergjigja nga AK rreth kërkesës për Rishqyrtim
- g) Kërkesa për Rishqyrtim e dates 12.02.2020
- h) Dëshmi nga e-prokurimi i kërkesës për Rishqyrtim
- i) Pergjigja e AK-së e dates 14.02.2020 (kthehet lenda në Rivleresim)
- j) Njoftimi mbi vendimin e AK-së si dhe letra standarde për tenderuesin e eliminuar- data 02.03.2020
- k) Kërkesa për Rishqyrtim e dates 06.03.2020
- l) Dëshmi nga e-prokurimi i kërkesës për Rishqyrtim
- m) Dëshmi nga e-prokurimi i pergjigjes nga AK- data 11.03.2020
- n) Pergjigja e AK-së e dates 11.03.2020
- o) Njoftimi për dhenie të kontratës- pa pritur afatin ligjor për ankese

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

